

STATUTI
I SHOQUERISË TREGTARE

“Northern PikHost” sh.p.k.

Në këtë statut:

“Ligji” është Ligji Nr.9901, Dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqeritë tregtare.

“Statuti” është Statuti i Shoqerisë.

I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Shoqëria **“Northern PikHost”** Sh.p.k rregullon pozitën e saj juridike, llojin e shoqerisë, marrëdhieniet e themeluesve, të organëve të saj, kohëzgjatjen e veprimatrissë së saj, marrëdhieniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare", Kodin e Punës, si dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhieniet e Shoqërive Tregtare.

Neni 1

Data e themelimit

Sot, Shkodër më *Dt. 10.08.2023*, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me pernjegjësi të kufizuar me emrin **“Northern PikHost”** Sh.p.k.

Neni 2

Objekti i veprimitarissë:

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Agjensi turistike. Operator Turistik. Sherbime te udherrefimit turistik. Sherbime ndermjetesimi per shitjen e sherbimeve te hotelerise dhe turizmit. Aktivitete te hotelerise. Aktivitete turistike. Konsulenca te gjitha llojeve rrith turizmit dhe gjithçka që perfshin turizmin. Sherbime marketingu online, Konsulenca manaxhim, Web design, Shitje te Domaineve online, Manaxhim dhe mirembajtje te rrjetave sociale. Dhenie dhe marrje me qira te pronave.

Neni 3

Emri dhe selia e Shoqerisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin: **“Northern PikHost”** sh.p.k.

Selia e Shoqerisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Shkodër, Lagjia "G'juhadol", Rruga G'juhadol, Zona kadastrale 8593, Nr. Pasurie 4/144+1-4.

Neni 4


Kohëzgjatja e Shoqerisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqerisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimitarissë dhe me pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

Neni 5

Regjimi Juridik i Shoqerisë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton



parimin e reciprocitetit.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjisacionit në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, shoqëria mundet që të ndryshoje regjimin juridik të saj në perputhje me dispozitat ligjore qe do të jenë në fuqi si dhe në perputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vullën e saj.

II. TËDREJTAT DHE DETYRA T E ORTAKËVE

Neni 6

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të ortakëve themelues të shoqërisë në përpjestim të drejtë me kuotat që zoterojnë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng në hipotekë me miratimin e Ortakëve.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

Ortakët japid kontributin në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigen ndaj shoqerisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtjerë afateve përkatëse. Personi/at përgjegjës për administrimin e shoqerisë informojnë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqerisë tregtare dhe me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqerisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqerisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vleresuar nga shoqëria si infonnacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të pa autorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqerisë.

Ortakët veprojnë duke marrë parasysh interasat e shoqerisë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiken për fillimin e aktivitetit të Shoqerisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

Neni 8

Abuzimi i ortakëve ndaj shoqerisë

Ortakët e shoqerisë tregtare që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht ose në mënyrë solidare për detyrimet e shoqerisë, me të gjithë pasuritë e tij nëse:

- a. Abuzojnë me formën e shoqerisë tregtare dhe paraqitjen e qëllimeve të paligjshme
- b. Trajtojnë pasuritë e shoqerisë tregtare si të ishte pasuri e tij;
- c. Në rastin kur kane marre apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqerisë, nuk marrin masat e nevojshme për të siguruar që shoqëria, në varësi të llqit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitalet e mjaftueshme për të përbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

d.

Neni 9

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQUERISË

Veprimtaria e funksionimit të Shoquerisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe paqyrohet në bilancet e saj.

Neni 10

Kapitali i Shoquerisë dhe Ortakët

Kapitali i shoquerisë është në vlerën **100,000** (Njëqindmijë) lekë, i ndarë në 2 kuota me nga 1 kuotë për secilin.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare me emrin "**Northern PikHost**" Sh.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Sanida Kraja, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 30.09.1991, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034751539 dhe Nr. Personal J15930100T zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit i cili ka vleren 50,000 lekë.

Benida Beqiri, shtetas shqiptare, i ditëlindjes 22.05.1991, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032666122 dhe Nr. Personal J15522095S zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit i cili ka vleren 50,000 lekë.

Kapitali themeltar do te shlyhet plotësisht në para nga Ortakët me themelin e Shoqërisë dhe hapjen e niptit dhe llogarise bankare. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

Neni 11

Pronësia mbi kuotat

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoquerisë:

- a) Me shit-bljerës
- b) Me trashëgimi
- c) Me dhurim
- d) Me çdo menyrë tjetër të parashikuar më ligj

Neni 12

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve i përbërë nga ortakët themelues të shoquerisë.

Neni 13

Forma e transferimit

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, pasi ndryshe janë të pavlefshme.

Neni 14

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themelor mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kerkojnë interesat e Shoquerisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoquerisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të demtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek këta, ose që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

Neni 15

Fondet rezervë

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fondet e tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 16

Përdorimi i të ardhurave neto

E ardhura neto që realizohet mbasi zbritën shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti, nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatifit e taksa, nga kuota që rrjedhin nga kreditë për investime, paga, shpërblime, u kalojnë në pronësi ortakëve në përpjestim të drejtë me kuotat që kanë në shoqëri dhe përdoren prej tyre për qëllime të veta.

Neni 17

Bilanci

Pasuria e Shoqerisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhën e vendit ose në monedhë të huaj, sipas vlerësimit të Asamblesë së ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqerisë. Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me formatet e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqiperisë sipas legjislacion fiskal ne fuqi.

Neni 18

Plani finanziar

Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik te Shoqërisë të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqiperi. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

Neni 19

Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të mbajnë pjesën e fitimit të deklaruar të pasqyrat financiare të shoqerisë.


IV. ORGANET E SHOQERISË

Neni 20

Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqerisë është Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga Ortakët e shoqerisë. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqerisë
- Ndryshimet e statutit
- Emërimin e shkarkimin e administratorëve
- Emëri min e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;



- Përcakti min e shpërblim eve për administratorin/ët, likuiduesin dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët. Përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë:
- Zmadhimin dhe zvogëlimin c kapitalit;
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve:
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 21

Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqerisë. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret jo më pak se një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirreth nga administrator/ët apo nga ortakët e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- Sipas bilancit vjetor apo raportëve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqerisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Neni 22

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet njoftimit shkresor ose me njoftimin nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi shkresor apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe i dërgohet ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Neni 23

Vendim-marrja

Të gjitha vendimet merren nga asambleja e Përgjithshme e Shoqerisë.

Neni 24

Procesverbal i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të registrohen në Procesverbal. Administratori/ët kujdeset dhe përgjigjet për ruajtjen e kopjes së procesverbalit të mbledhjes së asamblesë.

Proces Verbal duhet të përmbajë datën, vendin, orën, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të Proces-Verbalit, rezultatet e votimit.


Proces-Verbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si dhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Proces-Verbalit i mbledhjes nënshkruhet nga ortakët dhe nga mbajtësi i procesverbalit.



V.

ADMINISTRIMI I SHOQERISË



Neni 25

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona si administrator të shoqerisë. Afati i emërimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregullat e posaçme për emërimin e administratorëve.

Administrator caktohet për një afat 5-vjeçar, **Sanida Kraja**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 30.09.1991, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034751539 dhe Nr. Personal J15930100T.

Shoqeria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretë nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqerisë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 26

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqerisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.
- Përfaqëson shoqerinë tregtare.
- Kujdeset dhe është përgjegjës për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqerisë.
- Përgatisë dhe nënshkruej bilancin vjetor. Bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
- Krijojë një sistem paralajmërimi në kohen e duhur për rr Ethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqerisë;
- Kryejë regjistrimet dhe dergojë të dhënat e detyrueshme të shoqerisë, sipas ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçantë për veprimtarinë e shoqerisë tregtare.
- Kryen/jnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Të thërrasin asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, që kanë vlerë me të lartë se 5 përqind të asetëve të shoqerisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kursi pas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqerisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

VI. MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 27

Marrëdhëni e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Akitit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqerisë e të

punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërjet kontratës kolektive të punës.

Neni 28

Të punësuarit dhe punonjësit drjtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që shkaktojnë Shoqerisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht apo penalisht.

VI. PRISHJA E SHOQERISË / LIKUJDIMI

Neni 29

Kjo Shoqëri do të prishet në rast kur Asambleja e Përgjithshme vendosë për prishjen e Shoqerisë duke emëruar një ose më shumë likujdues.

Prishja e shoqerisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori.

VII. DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 30

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqerisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Komëtare të Biznesit.

Neni 31


Gjithcka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet me parimin e mirëkuptimit dhe të sjelljës së mirë si dhe nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqiperisë.

Neni 32

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Sanida Kraja


Sanida Kraja

Benida Beqiri


Benida Beqiri